e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Data _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Specifikimi i Materialeve: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Tabela e përmbajtjes

Regjistrimi i ndryshimit të dokumentit	Error! Bookmark not defined.
Tabela e përmbajtjes	23
1 Hyrje	26
1.1 Qëllimi	26
1.2 Fushat e Veprimtarise	26
1.3 Ofertat dhe Vlerësimi	26
1.3.1 Përgjigja e tenderit	27
1.3.2 Matrica e Pajtueshmërisë	27
1.3.3 Ofrimi i punimeve	27
1.4 Përkufizimet	27
1.5 Referencat	27
2 Kërkesa e Përgjithshme	28
2.1 Dërgesat	28
3 ARM (Disponueshmëria, Besueshmëria, Mirëmbajtja)	29
3.1 Disponueshmëria	29
3.2 Besueshmëria	29
3.3 Mirëmbajtja	29
4. Mjedisi Ambient	29
4.1 Kushtet e Operimit	29
4.2 Mjedisi jo operacional (transporti, magazinimi)	30
4.3 Dokumentacioni	30
5. Karakteristikat e radiove ajrore tokësore	31
5.1 Karakteristikat e transmetuesit dhe marrësve VHF	31

5.1.1	Karakteristikat e transmetuesit VHF	31
5.1.2	Karakteristikat e Marrësit VHF.....	32
5.2	Karakteristikat e transmetuesit dhe marrësve UHF	32
5.2.1	Karakteristikat e transmetuesit UHF	32
5.2.2	Karakteristikat e Marrësit UHF.....	33
6.	Stacioni i Karaburunit	35
6.1	Arkitektura e Stacionit	35
6.2	Pajisjet e radios	35
6.3	Lidhje Microwave (Radio Ura).....	35
6.4	Kabllo, Antena	35
6.5	Mjedisi i instalimit	35
6.6	Gjenerator	36
6.7	Transformator i tensionit të mesëm në tension të ulët	36
6.8	Shelteri i pajisjeve.....	36
6.9	UPS	37
6.10	Furnizimi me energji elektrike DC	37
7.	Stacioni i Kullës së Vlorës	38
7.1	Arkitektura e Stacionit	38
7.2	Pajisjet e radios	38
7.3	Kabllo, Antena	38
7.4	Furnizimi me energji DC	38
8.	Stacioni Malor i Krujës	39
8.1	Arkitektura e Stacionit	39
8.2	Pajisjet e radios	39
8.3	Kabllo, Antena	39
8.4	Furnizimi me energji DC	39

9.	Pajisjet e rrjetëzimit	40
10.	Shërbimet	41
10.1	Vizita ne Stacion	41
10.2	Instalimet.....	41
10.3	Integrimi.....	41
10.4	Testimi dhe vënia në punë	41
10.5	Transporti.....	41
10.6	FAT dhe SAT.....	41
10.6.1	Testi i pranimi në fabrikë (FAT).....	41
10.6.2	Testi i pranimi të sitit (SAT)	41
10.7	Trajnimit.....	42
10.8	Sigurimi i Përgjithshëm i Cilësisë.....	42
10.8.1	Standardet e Cilësisë	42
11.	Shtojca A: Fusha e Punës.....	43
11.1	Sasia dhe koha e dorëzimit.....	43

Hyrje

1.1 Qëllimi

Ofruesi i Shërbimit të Navigimit Ajror Shqiptar, Albcontrol, planifikon të zëvendësojë pajisjet ekzistuese të radios VHF në vendndodhjen Mali i Krujës dhe të ndërtojë një Stacion të ri për Aeroportin e Vlorës në Karaburun.

Zëvendësimi i pajisjeve ekzistuese VHF ka për qëllim të sigurojë një besueshmëri më të mirë – pajisjet aktuale janë në fund të ciklit të tyre të jetës.

Ndërtimi i stacionit të ri në Karaburun synon të plotësojë nevojat e Kullës së Aeroportit të Vlorës dhe operacionet e afrimit në kete Aeroport.

1.2 Fushat e Veprimtarise

Procesi do të ndahet në tre faza.

Faza e parë do të përfshijë sa vijon:

1. Ndërtimi i stacionit të ri në vendndodhjen Karaburun.
2. Instalimi i pajisjeve VHF në këtë stacion.
3. Integrimi i sistemit të monitorimit në distancë të këtij stacioni në Aeroportin e Vlorës (Kulla e Re) dhe në Aeroportin e Tiranës (Ambientet e Albcontrol).
4. Integrimi me VCS në Aeroportin e Vlorës për Frekuencat e Kullës.
5. Integrimi me GAREX 230 VCS në Aeroportin e Tiranës (Ambientet e Albcontrol) për Frekuencat e Afrimit në Vlorë.

Faza e dytë do të përfshijë sa vijon:

1. Zëvendësimi i pajisjeve kryesore të radios në Stacionin e Malit të Krujës.
2. Integrimi i sistemit të monitorimit në distancë të këtij stacioni në Aeroportin e Tiranës (Ambientet e Albcontrol).
3. Integrimi i këtyre radiove në GAREX VCS në Ambientet e Albcontrol.

Faza e tretë do të përfshijë sa vijon:

1. Zëvendësimi i pajisjeve të radios StandBy në Stacionin e Malit të Krujës.
2. Integrimi i sistemit të monitorimit në distancë të këtij stacioni në Aeroportin e Tiranës (Ambientet e Albcontrol).
3. Integrimi i këtyre radiove në GAREX VCS në Ambientet e Albcontrol.
- 4.

1.3 Ofertat dhe Vlerësimi

Ne rastet kur Operatori Ekonomik evidenton konflikte midis specifikimeve dhe standarteve të listuara si reference, Ai duhet të identifikojë qartësisht konfliktin dhe të përgjigjet kërkesave në këtë dokument.

Per kërkesat konfliktuale mund të jepet një përgjigje.

1.3.1 Përgjigja e tenderit

Të gjitha referencat për implikimet e kostos dhe detajet specifike të kostos do të shfaqen vetëm në përgjigjen komerciale, jo në përgjigjen teknike.

Informacioni ose të dhënat e dhëna në përshkrimet dhe specifikimet e propozimit që lidhen me secilin nga paragrafët e këtij specifikimi do të jepen me reference.

1.3.2 Matrica e Pajtueshmërisë

Pajtueshmëria me specifikimet kërkohet, përveç rasteve kur mund të demonstrohet largimi nga kërkesat e specifikimeve gjatë thirrjes për tender për të ofruar avantazhe teknikisht ose për të ofruar avantazhe në terma të kostos pa degradim në performancë. Përgjigja ndaj specifikimit kërkohet të jetë e kuptueshme me një Përmbledhje të Pajtueshmërisë së plotë

1.3.3 Ofrimi i punimeve

Kontraktori do të instalojë sistemin e radios VHF bazuar në një projekt Turk Key. Kontraktori do të mbështesë Albcontrol në integrimin e radiove VHF në Kullën e Vlorës dhe Stacionin e Karaburunit me Vlora Tower VCS dhe Tirana ACC VCS që është Garex 230.

Kontraktori do të përfundojë punimet e tij në një periudhë 6-8 muaj

1.4 Përkufizimet

1. Përdorimi i fjalës “Do të ose Duhet të” pershkruan nje kerkese te detyrueshme.
2. Përdorimi i fjalës “rekomandohet, preferohet” pershkruan nje kriter I cili eshte opsioni i preferuar.
3. “Operatori Ekonomik” nenkuptone kompanine qe merr pjese ne tender.
4. “Kontraktuesi” nenkupton operatorin ekonomik I cili ka fituar kontraten per te kryer projektin.

1.5 Referencat

- [1] ICAO ANEX 10 Volume I
- [2] ICAO ANEX 10 Volume III
- [3] ICAO ANEX 10 Volume V
- [4] ICAO EUR Doc 011, EUR Manuali i menaxhimit te frekuencave
- [5] ICAO Doc 9718, Handbook on Radio Frequency Spectrum Requirements for Civil Aviation
- [6] ETSI EN 300 676 (latest official edition) Ground-based VHF hand-held, mobile and fixed radio transmitters, receivers and transceivers for the VHF aeronautical mobile service using amplitude modulation; Technical characteristics and methods of measurement.
- [7] ETSI EN 301 489-22 (latest official edition) - EMC standard for radio equipment and services; Specific conditions for ground-based VHF aeronautical mobile and fixed radio equipment.
- [8] IEC 60950 - International Safety Standard for Information Technology Equipment
- [9] EN 60215 - Safety of Radio Frequency Transmitters
- [10] EUROCAE ED-136 VOIP Operational and Technical Requirement
- [11] EUROCAE ED-137 Interoperability Standards for VOIP ATM Components (Radio, Telephone, recording, supervision)
- [12] EUROCAE ED 138 Network Requirements and Performance Part 1 & Part 2

Kërkesa e Përgjithshme

Albcontrol ka ne pune nje system komunikimi me radio VHF/UHF te instaluar ne Malin e Krujes si dhe do te ndertoje nje stacion te ri afer Aeroportit te Vlores ne gadishullin e karaburunit per avionet qe ulen dhe ngrihen nga Aeroporti i Vlores.

Ne Malin e Krujes jane te instaluara radio VHF dhe UHF per komunikimet e Toke Ajër te ACC tirane si dhe per Sektorët e Afrimit dhe Kullen e Aeroportit te Tiranës. Sistemi është operacional qe nga viti 2010. Albcontrol planifikon te zevendesojë sistemin egzistues ne Malin e Krujes me nje system te ri komunikimi Toke Ajër.

Ne lidhje me Aeroportin e Vlores pervec stacionit te ri ne karaburun albcontrol kerkon te ndertoje nje stacion backup ne kullen e Aeroportit Vlore.

Albcontrol kerkon nje zgjidhje me cilesi ne dore per sistemet VHF/UHF ne menyre qe te siguroje komunikimet zanore Toke – Ajër. Sipas specifikimeve te :

- ICAO SARPs Annex 10
 - Udhëzimet e Eurocontrol për mbështetjen e zbatimit Specifikimet e komunikimit dhe navigimit Transmetuesit dhe Marrësit VHF/UHF AM.
-
- 1- Mbulimi me radio do të jetë i tillë për të siguruar forcën e kërkuar në terren, siç specifikohet në SARP-të e ICAO për APP, TWR dhe ACC, zonat e kontrollit në hapësirën ajrore shqiptare si dhe për TWR të Tiranës dhe Vlorës dhe ACC të Tiranës.
 - 2- Në zonën e malit të Krujës ka infrastrukturë të furnizimit me energji elektrike dhe gjithashtu strehë dhe antena. Gjithashtu në zonën e Malit të Krujës ka prezencë të një Micro Wave Link me kapacitet 512mbps e cila ka një kapacitet 16 E1 (lidhje e trashëguar) dhe pjesa tjetër është TCP IP.
 - 3- Në gadishullin e Karaburunit, Albcontrol do të përdorë pozicionimin e ofruesve celularë në këtë pikë. Gjithashtu në këtë faqe Albcontrol synon të përdorë kullën e antenës së ofruesit celular për të vendosur antenën VHF të nevojshme për këtë stacion.
 - 4- Në Vlora Tower (vend rezervë) Albcontrol synon të instalojë pajisjet e radios brenda Kullës së Kontrollit dhe të përdorë çatinë e kësaj kulle për të instaluar Antenat.
 - 5- Ofertuesit janë të ftuar të vizitojnë lokacionet dhe të bëjnë vlerësimin që do të ndihmojë në bërjen e propozimit të projektimit të sistemit. Tenderuesit do të bëjnë dizajnin e detajuar të sistemit, do të llogarisin mbulimin e radios, produktet intermoduluese dhe interferencat.

1.6 Dërgesat

Zgjidhja e ofruar do të mbulojë :

- 1- Pajisjet e radios VHF në konfigurim kryesor/standby me filtra, kombinues, çiftues, kabllo dhe ndërfaqe të përshtatshme për sitet e Albcontrol ;
- 2- Multiplekserë, lidhje mikrovalore dhe pajisje të tjera të nevojshme komunikimi për lidhjen e pajisjeve radio dhe RCMS nga Karaburuni dhe mali i Krujës me dhomën Teknike në ambientet e Albcontrol në Aeroportin e Vlorës dhe Aeroportin e Tiranës;
- 3- Pajisjet e përshtatshme të telekomunikacionit për lidhjen e pajisjeve radio dhe RCMS nga sitet lokale në dhomën teknike të ambienteve të Albcontrol në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës (Switches dhe Routers)
- 4- Sistem antenash me pajisje të përshtatshme montimi dhe tokëzimi në të gjitha vendet;
- 5- Punimet e duhura civile dhe instalimi i pajisjeve të lartpërmendura;
- 6- Llogaritjet e mbulimit me radio (vizatime dhe tabela) dhe intermodulimi ;

- 7- Testimi, matja dhe vënia në punë e artikujve të instaluar;
- 8- Trajnim për operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të instaluara;
- 9- Çdo stacion radio do të lidhet me QV në Tiranë dhe QV në Vlorë nëpërmjet VOIP. Kontraktori do të mbështesë integrimin e këtyre radiove në sistemin përkatës VCS.
- 10- Për të mundësuar lidhjen me VCS, çdo radio duhet të ketë një ndërfaqe integrale Ethernet të dedikuar për VoIP sipas EUROCAE ED 137;
- 11- Për të mundësuar lidhjen RCMS ndërmjet pajisjeve radio dhe sistemit TMCS, çdo radio duhet të ketë një ndërfaqe integrale të dedikuar Ethernet me protokollin SNMP sipas EUROCAE ED 136, ED 137B;
- 12- Duhet të jetë i mundur konfigurimi i radios me 2 adresa IP të ndryshme për audio (SIP/RTP) dhe telekomandë (RCMS).
- 13- Kontraktori do të mbështesë autoritetin kontraktor për të vendosur lidhjen e duhur ndërmjet pajisjes radio dhe VCS. Faqja e re e radios në Karaburun duhet të jetë në gjendje të lidhet me QV-të ekzistuese në Tiranë dhe QV-të e reja në Vlorë në të njëjtën kohë. ARM (Disponueshmëria , Besueshmëria, Mirëmbajtja)

ARM (Disponueshmëria, Besueshmëria, Mirëmbajtja)

1.7 Disponueshmëria

Disponueshmëria do të jetë më shumë se 99,99995 % për sistemin e plotë si dhe për lidhjet me sistemet VCS.

3.2 Besueshmëria

Duke qenë se sistemi i radios është një pajisje kritike, ai duhet të ketë një besueshmëri shumë të lartë. Dështimi i ndonjë komponenti të vetëm do të nënkuptojë, më së shumti, humbjen e vetëm një pajisjeje në sistem dhe nuk do të ndikojë në funksionimin e të gjithë sistemit.

3.3 Mirëmbajtja

Sistemi radio i ofruar do të përdorë konceptin e mëposhtëm të mirëmbajtjes:

Dështimet brenda sistemit do të zbulohen dhe identifikohen automatikisht deri në nivelin e bordeve ose shërbimit, duke përdorur softuerin diagnostikues në internet. Mosfunksionimet duhet të tregohen vizualisht në Sistemin e Monitorimit dhe Kontrollit në distancë. Të gjithë komponentët kritikë do të dublikohen me zgjedhjen automatike të komponentit të disponueshëm të sistemit.

Gjithashtu monitorimi automatik i defekteve të të gjitha furnizimeve me energji elektrike. Nuk duhet të nevojiten regullime manuale në bordet e sistemit.

Në monitor dhe në printer duhet të jetë i disponueshëm një skedar i regjistrit të gabimeve për një raport të vazhdueshëm gabimi.

5. Mjedisi Ambient

4.1 Kushtet e Operimit

Temperatura e funksionimit:

+5°C deri +40°C me ftohje të detyruar të kabineteve të ndërfaqes (Përfshihen Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit Teknik)

+5°C deri +25°C pa ftohje të detyruar të kabineteve të ndërfaqes Lagështia: deri në 90% pa kondensim

4.2 Mjedisi jo operacional (transporti, magazinimi)

Specifikimet e mëposhtme duhet të plotësohen gjatë magazinimit dhe transportit:

Temperatura: -15°C deri +70°C Lagështia gjatë transportit: +40°C, 90%

Dridhja gjatë transportit: 0,3 mm, 10 Hz deri në 40 Hz (IEC 60068-2-6. Test Fc) 20 m/s², 40 Hz deri në 500 Hz (IEC 60068-2-6. Test Fc)

4.3 Dokumentacioni

Dokumentacioni i sistemit duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Manuali Teknik i Radios VHF/UHF
2. Manuali teknik i përdorimit të radios VHF/UHF për Sistemin e Konfigurimit dhe Monitorimit të Sistemit
3. Manuali i mirëmbajtjes së radios VHF/UHF
4. Të gjitha trajnimet – materiale specifike

5. Karakteristikat e radiove ajrore tokësore

5.1 Karakteristikat e transmetuesit dhe marrësve VHF

1. Frekuenca	-	117Mhz-137Mhz
2. Fuqia AC	-	230VAC $\pm 10\%$
3. Fuqia DC	-	19-32 VDC
4. Modulimi	-	AM-DSB

5.1.1 Karakteristikat e transmetuesit VHF

Radiot duhet të jenë në përputhje me ETSI EN 300676-1

1. Fuqia dalëse

Fuqia bartëse	-	50 W (nom.), -0 dB/+1 dB
Gama e konfigurueshme me madhësi hapash	-	5 W deri në 50 W, 1 W ndarja

2. Vetëmbrojtje

Mospërputhja e VSWR pa dëmtime	-	VSWR infinite (qark i hapur/i shkurtër), të gjitha fazat
Mbrojtje ndaj temperaturës	-	Ulja e fuqisë dalëse deri në 0 W

3. Operacioni i kompensimit

Ndarja 25 kHz	-	± 5 kHz
Ndarja 8.33 kHz	-	$\pm 2,5$ kHz

4. Thellësia e modulimit

-	i konfigurueshëm midis 30% dhe 90%, në ndarje 1%.
---	---

5. Ndërfaqja audio dixhitale (VoIP)

Kontrolli i sesionit	-	SIP – EUROCAE ED137C dhe B
Transmetim audio	-	RTP - EUROCAE ED137C dhe B
Kodifikimi i audios	-	ITU-T G711
Regjistruar zëri	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 4
Mbikëqyrja	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 5

5.1.2 Karakteristikat e Marrësit VHF

Radiot duhet të jenë në përputhje me ETSI EN 300676-1

1. Receive Sensitivity në 10 dB (S+N)/N të ponderuar ITU-T, 1 kHz, m = 30 %	-	≤ -107 dBm
2. Ndërfaqja audio dixhitale (VoIP)		
Kontrolli i sesionit	-	SIP – EUROCAE ED137C dhe B
Transmetim audio	-	RTP - EUROCAE ED137C dhe B
Kodiku i audios	-	ITU-T G711
Regjistruar zëri	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 4
Mbikëqyrja	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 5

5.2 Karakteristikat e transmetuesit dhe marrësve UHF

5. Frekuenca	-	225Mhz-400Mhz
6. Fuqia AC	-	230VAC $\pm 10\%$
7. Fuqia DC	-	19-32 VDC
8. Modulimi	-	AM-DSB

5.2.1 Karakteristikat e transmetuesit UHF

Radiot duhet të jenë në përputhje me ETSI EN 300676-1

6. Fuqia dalëse		
Fuqia bartëse	-	50 W (nom.), -0 dB/+1 dB
Gama e konfigurueshme me madhësi hapash	-	5 W deri në 50 W, ndarje 1 W

7. Vetëmbrojtje

Mospërputhja e VSWR pa dëmtime	-	VSWR infinite (qark i hapur/i shkurtër), të gjitha fazat
Mbrojtje ndaj temperaturës	-	Ulja e fuqisë dalëse deri në 0 W
8. Operacioni i kompensimit		
Ndarja 25 kHz	-	± 5 kHz
9. Thellësia e Modulimit		
	-	i konfigurueshëm midis 30% dhe 90%, në hapa 1%.
10. Ndërfaqja audio dixhitale (VoIP)		
Kontrolli i sesionit	-	SIP – EUROCAE ED137C dhe B
Transmetim audio	-	RTP - EUROCAE ED137C dhe B
Kodiku i audios	-	ITU-T G711
Regjistruar zëri	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 4
Mbikëqyrja	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 5

5.2.2 Karakteristikat e Marrësit UHF

Radiot duhet të jenë në përputhje me ETSI EN 300676-1

3. Receive Sensitivity

në 10 dB (S+N)/N të ponderuar ITU-T, ≤ -107 dBm

1 kHz, m = 30 %

4. Ndërfaqja audio dixhitale (VoIP)

Kontrolli i sesionit	-	SIP – EUROCAE ED137C dhe B
Transmetim audio	-	RTP - EUROCAE ED137C dhe B
Kodiku i audios	-	ITU-T G711
Regjistrues zëri	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 4
Mbikëqyrja	-	EUROCAE ED137C dhe B Vol. 5

6. Stacioni i Karaburunit

6.1 Arkitektura e Stacionit

Stacioni do të instalohet në gadishullin e Karaburunit . Ky stacion do të bashkohet me një stacion ofrues celular. Tenderuesi duhet të bëjë një studim në terren në këtë stacion përpara se të bëjë ofertën.

Ky stacion do të ketë radio (transmetues dhe marrës) në VHF për zonen e afrimit (approach) e Vlorës dhe Kullën e Vlorës . Për çdo frekuencë që do të përdoret sistemi do të ketë transmetues dhe marrës kryesor dhe rezervë.

6.2 Pajisjet e radios

Stacioni do të pajiset me:

- 1- 12 copë transmetues ku konfigurimi duhet të jetë një primar dhe një ne gjendje gatishmëri. Në total do të konfigurohen 6 frekuenca.
- 2- 12 cope Marrës ku konfigurimi duhet të jetë një primar dhe një ne gjendje gatishmëri. Në total do të konfigurohen 6 frekuenca.

6.3 Lidhje Microwave (Radio Ura)

Kontraktori do të sigurojë dhe instalojë një sistem radio ure për mbështetjen e komunikimeve të Stacionit me Aeroportin e Vlorës .

- 1- Radio Ura duhet të jetë 1+1 për elementët e saj të brendshëm dhe të jashtëm.
- 2- Ai duhet të mbështesë kapacitetin e transmetimit të të dhënave të paktën 100 mbps.
- 3- Duhet të mbështesë të paktën 4 E1 dhe pjesa tjetër e kapacitetit do të jetë Ethernet .

6.4 Kabllo, Antena

Kontraktori do të sigurojë dhe instalojë kabllo dhe antenat e nevojshme për të lidhur të gjithë transmetuesit dhe marrësit. Sistemi duhet të jetë i pajisur me filtra të kavitetit për të krijuar ndarjen e nevojshme ndërmjet transmetuesve dhe marrësve në të njëjtën frekuencë.

Për kullen Antenës, do të përdoret kulla e pronarit të stacionit.

Të gjitha kabllo RF duhet të bëhen sipas standardeve të instalimit me tokëzim dhe të mbrojtur nga goditjet e rufeve.

6.5 Mjedisi i instalimit

Stacioni furnizohet me një linjë elektrike 10 KV dhe transformatori ekzistues nuk mban ngarkesën shtesë të nevojshme për radiot e reja VHF. Për këtë arsye kontraktori do të furnizojë dhe instalojë:

- 1- Një transformator i jashtëm minimal 50KVA nga 10KV/400 V
- 2- Një gjenerator i vlerësuar të paktën me fuqi 30 KVA për të furnizuar stacionin VHF

Kontraktori do të furnizojë 2 shelter:

- 1- Shelter për radiot VHF dhe pajisjet e komunikimit
- 2- Shelter për Gjeneratorin dhe depozitën e karburantit.

Kontraktori do të rregullojë gardhin e stacionit (të vendosë atë të ri ose të rregullojë ekzistuesin) për sigurinë fizike të stacionit.

6.6 Gjenerator

Zona duhet të jetë e pajisur me një gjenerator 3 fazor me një fuqi nominale të paktën 30 KVA. Gjeneratori do të instalohet brenda një shelteri për mbrojtjen e mjedisit. Gjeneratori duhet të jetë me naftë dhe brenda shelterit të tij duhet të ketë një depozitë shtesë karburanti për të paktën 500 litra karburant.

Gjeneratori duhet të jetë automatik dhe i pajisur me një celes të transferimit automatik.

Gjeneratori do të jetë i pajisur me një ndërfaqe monitorimi e cila do të monitorohet nga Aeroporti i Vlorës nga e cila mund të kontrollohet nga distanca statusi i gjeneratorit dhe parametrat e tij si:

- 1- Niveli i karburantit të depozitës së brendshme të gjeneratorit dhe depozitës së jashtme.
- 2- Temperatura e vajit
- 3- Alarmet e gjeneratorëve
- 4- Tensioni dhe rryma e furnizuar nga gjeneratori
- 5- Statusi i gjeneratorit ATS
- 6- Statusi i derës së shelterit (Alarmi)

Shelteri i gjeneratorit do të jetë e pajisur me një sistem detektimi dhe shuarje zjarri, i cili do të monitorohet nga distanca nga Aeroporti i Vlorës .

6.7 Transformator i tensionit të mesëm në tension të ulët

Kontraktori do të mundesoje një transformator të ri të tensionit të mesëm në tension të ulët për të gjithë stacionin. Ky transformator do të zëvendësojë transformatorin ekzistues i cili është në stacionin ekzistues.

Transformatori duhet të jetë 3 fazor me karakteristika:

Fuqia: 50 KVA

Tensioni Primar 10KV

Tensioni sekondar 400 V

6.8 Shelteri i pajisjeve

Shelteri që do të mbaje radiot VHF dhe pajisjet e tjera duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për të instaluar radiot VHF, një UPS, furnizim me tension DC dhe bateri për sistemin.

Ai do të jetë i pajisur me:

- 1- Sensorët e mjedisit si lagështia e temperaturës dhe rrjedhja e ujit
- 2- Sistemi i zbulimit dhe shuarjes së zjarrit
- 3- Sistemi i aksesit dhe sistemi kundër vjedhjes
- 4- Ai duhet të ketë kamera të brendshme dhe të jashtme të cilat do të monitorojnë të gjithë rrethinën e stacionit.
- 5- Shpërndarja e energjisë e stacionit do të monitorohet për parametrat e fuqisë si rryma e tensionit dhe cilësia e energjisë gjithashtu për statusin e MCB (të fikur ose jo) të instaluar në kornizën e shpërndarjes së energjisë
- 6- Dy kondicionerë të cilët do të jenë të tipit industrial dhe të monitoruar dhe kontrolluar nga distanca

I gjithë ky sistem do të monitorohet dhe kontrollohet nga distanca nga Aeroporti i Vlorës për të cilin kontraktori do të furnizojë softuerin e nevojshëm të monitorimit dhe kontrollit në distancë.

6.9 UPS

UPS-ja duhet të jetë 3 fazore me fuqi të paktën 20 KVA dhe autonomi minimale 30 min. UPS do të ketë ndërfaqen e nevojshme për monitorimin dhe kontrollin në distancë (protokolli i preferuar SNMP për monitorim).

UPS-ja do të jetë e tipit Online dhe do të mbështesë vetëm pajisjet operative dhe monitoruese të mjedisit. Kondicioneri nuk duhet të lidhet nën UPS.

6.10 Furnizimi me energji elektrike DC

Stacioni duhet të jetë i pajisur me një furnizim me energji DC dhe bateri për të ushqyer radiot VHF dhe lidhjen e mikrovalës, bateritë e lidhura duhet të mbështesin radiot VHF dhe mikrovalën për të paktën 8 orë.

Furnizimi me energji DC do të monitorohet dhe kontrollohet nga distanca nga Aeroporti i Vlorës (protokolli i preferuar SNMP për monitorim).

7. Stacioni i Kullës së Vlorës

7.1 Arkitektura e Stacionit

Stacioni do të instalohet në Kullën e Vlorës . Pajisjet do të instalohen poshtë kabinës së kullës në një dhomë të dedikuar për pajisjet. Tenderuesi duhet të bëjë një studim në terren në këtë stacion përpara se të bëjë ofertën.

Ky stacion do të ketë radio (transmetues dhe marrës) në VHF për Kullën e Vlorës . Për çdo frekuencë që do të përdoret sistemi do të ketë një transmetues dhe marrës kryesor dhe rezervë.

7.2 Pajisjet e radios

Stacioni do të pajiset me:

- 3- 8 copë transmetues ku konfigurimi duhet të jetë kryesor dhe gatishmëri. Në total do të konfigurohen 4 frekuenca.
- 4- 8 copë Marrës ku konfigurimi duhet të jetë kryesor dhe gatishmëri. Në total do të konfigurohen 4 frekuenca.

7.3 Kabllo, Antena

Kontraktuesi do të sigurojë dhe instalojë kabllo dhe antenat e nevojshme për të lidhur të gjithë transmetuesit dhe marrësit. Sistemi duhet të jetë i pajisur me filtra të zgavrës për të krijuar ndarjen e nevojshme ndërmjet transmetuesve dhe marrësve në të njëjtën frekuencë.

Për Direk antenash do të përdoret çatia e kabinës së kullës

Të gjitha kabllo RF duhet të bëhen sipas standardeve të instalimit me tokëzim dhe të mbrojtur nga goditjet e ndriçimit me shkarkues me shumë goditje.

7.4 Furnizimi me energji DC

Stacioni duhet të jetë i pajisur me një furnizim me energji DC dhe bateri për të ushqyer radiot VHF, bateritë e lidhura duhet të mbështesin radiot VHF për të paktën 8 orë.

Furnizimi me energji DC do të monitorohet dhe kontrollohet nga distanca nga dhoma e të dhënave të Aeroportit të Vlorës (protokolli i preferuar SNMP për monitorim).

8. Stacioni Malor i Krujës

8.1 Arkitektura e Stacionit

Pajisjet do të instalohen në Stacionin Malor të Krujës . Pajisjet do të instalohen në shelerin ekzistues i cili është i pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme ambientale dhe energjetike . Tenderuesi duhet të bëjë një studim në terren në këtë stacion përpara se të bëjë ofertën.

Ky stacion do të ketë radio (transmetues dhe marrës) në VHF dhe UHF Tirana ACC dhe Tower. Për çdo frekuencë që do të përdoret sistemi do të ketë një transmetues dhe marrës kryesor dhe rezervë.

8.2 Pajisjet e radios

Stacioni do të pajiset me:

- 5- 20 copë transmetues ku konfigurimi duhet të jetë kryesor dhe gatishmëri. Në total do të konfigurohen 10 frekuenca ku 2 prej tyre janë në UHF.
- 6- 20 copë Marrës ku konfigurimi do të jetë kryesor dhe gatishmëri. Në total do të konfigurohen 10 frekuenca ku 2 prej tyre janë në UHF.

8.3 Kablo, Antena

Kontraktuesi do të sigurojë dhe instalojë kabllo dhe antenat e nevojshme për të lidhur të gjithë transmetuesit dhe marrësit. Sistemi duhet të jetë i pajisur me filtra të zgavrës për të krijuar ndarjen e nevojshme ndërmjet transmetuesve dhe marrësve në të njëjtën frekuencë.

Për Direk Antenash do të përdoren Direkt ekzistues në stacion

Të gjitha kabllo RF duhet të bëhen sipas standardeve të instalimit me tokëzim dhe të mbrojtur nga goditjet e ndriçimit me shkarkues me shumë goditje.

8.4 Furnizimi me energji DC

Stacioni duhet të pajiset me një furnizim me energji DC dhe bateri për të ushqyer radiot VHF. bateritë e lidhura duhet të mbështesin radiot VHF/UHF për të paktën 8 orë.

Furnizimi me energji DC do të monitorohet dhe kontrollohet nga distanca nga dhoma e të dhënave të Aeroportit të Tiranës (protokolli i preferuar SNMP për monitorim).

9. Pajisjet e rrjetëzimit

Kontraktori do të sigurojë dhe instalojë të gjitha pajisjet e nevojshme të rrjetit për të tre stacionet. Pajisjet e Rrjetit do të mbështesin mundësinë e krijimit të VLANS të ndryshëm dhe protokolleve të ndryshme të rrugëtimit.

Këto pajisje do të përdoren për lidhjen e radiove dhe pajisjeve të tjera mbështetëse si gjeneratorë UPS monitorues të ambientit etj në një rrjet të vetëm për t'u transmetuar drejt aeroportit të Vlorës dhe aeroportit të Tiranës në objektet e Albcontrol .

Kontraktori do të projektojë rrjetin sipas nevojave të sistemit dhe ky projekt do të miratohet nga Albcontrol

10. Shërbimet

10.1 Vizita ne Stacion

Ofertuesit mund të bëjnë një studim në terren me koston e tyre. Vizita ne stacion është shumë e rekomandueshme për shkak të kompleksitetit të projektit dhe nevojës për të bërë një ofertë cilësore

10.2 Instalimet

Të gjitha instalimet do të jenë përgjegjësi e furnizuesit. Instalimet duhet të bëhen sipas standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të prodhuesit

Furnizuesi do të ndërmarrë instalimin e plotë të stacioneve radiofonike dhe do t'i integrojë ato në VCS të Re të Vlorës dhe në VCS ekzistuese të Tiranës që është Garex 230. Sistemet do të dorëzohen plotësisht funksionale dhe të testuara.

10.3 Integrimi

Të gjitha sistemet e specifikuar duhet të integrohen në një sistem të përgjithshëm komunikimi. I gjithë sistemi duhet të funksionojë sipas qëllimit të këtij projekti dhe në përputhje me standardet e ICAO

10.4 Testimi dhe vënia në punë

Testimi dhe vënia në punë do të bëhet për çdo nënsistem individual dhe për të gjithë sistemin e komunikimit. Do të zbatohen standardet ndërkombëtare

10.5 Transporti

Transporti, sigurimi, zhdoganimi, ruajtja, ruajtja e pajisjeve dhe mallrave të tjera do të jetë përgjegjësi e furnizuesit

10.6 FAT dhe SAT

1. Testi i pranimi në fabrikë (FAT) do të jetë i detyrueshëm dhe do të kryhet në ambientet e Kontraktorit. Testi i pranimi të vendit (SAT) do të jetë i detyrueshëm dhe do të kryhet në vendin e instalimit.
2. Kontraktori do të jetë përgjegjës për të rregulluar dhe kryer testimin e pranimi.
3. Kontraktori do të përballojë koston e të gjitha burimeve të kërkuara për testimin (përfshirë personelin dhe ambientet) për të përfunduar Testet e Pranimi.
4. Kontraktori do të përgatisë një draft specifikim testimi 60 ditë përpara fillimit të FAT & SAT. Ky specifikim duhet të miratohet nga Albcontrol 30 ditë përpara fillimit të testit.

10.6.1 Testi i pranimi në fabrikë (FAT)

1. FAT do të provojë se pajisja plotëson të gjitha specifikimet e zbatueshme dhe do të plotësojë kërkesat operacionale dhe të performancës të këtij specifikimi.
2. Testi i pranimi në fabrikë do të përfshijë:
 - a. Identifikimi i çdo komponenti në nivelin e LRU; Detajet e konfigurimit të harduerit;
 - b. Vërtetimi i performancës së sistemit.
3. Kontraktori duhet të informojë blerësin të paktën 30 ditë përpara për gatishmërinë e FAT.
4. Vetëm pas FAT të suksesshëm, Kontraktori do të lejohet të dorëzojë pajisjet në vendin e instalimit.
5. Nëse sistemi nuk arrin të përmbushë kërkesat minimale të pranueshme të testimit dhe validimit, një FAT shtesë do të organizohet në një kohë të përshtatshme për Albcontrol pa disavantazh ndaj çdo detyrimi kontraktual në emër të Albcontrol dhe do të rregullohet tërësisht me shpenzimet e kontraktorit.

10.6.2 Testi i pranimi të sitit (SAT)

1. SAT do të fillojë pas instalimit të suksesshëm të sistemit.
2. SAT do të demonstrojë çdo funksion dhe performancën e sistemit sipas këtij specifikimi. Kontraktori do të përgatisë regjistrat e ndryshimeve të bëra që nga FAT nëse ka.
3. Kontraktori do të sigurojë të gjitha pajisjet e nevojshme të testimit, mjetet dhe instrumentet për SAT.

10.7 Trajnimi

1. Trajnimi do të përbëhet si më poshtë:

- Në trajnimi klase ne fabrike
- Në trajnim ne vendin e instalimit

2. Ofertuesi duhet të paraqesë një plan të detajuar trajnimi. Trajnimi duhet të bëhet në çdo sistem të furnizuar dhe konkretisht:

- a. Sistemi radio
- b. Sistemet mbështetëse (UPS , Furnizimi me energji DC, Mikrovalët).

3. 4 persona nga Albcontrol Do të trajnohen për menaxhimin dhe konfigurimin e sistemit në mënyrë që t'i mundësojë personelit të Albcontrol funksionimin e duhur të sistemit dhe kryerjen e nivelit 2 të mirëmbajtjes. Trajnimi duhet të përfshijë trajnime korrigjuese dhe parandaluese të mirëmbajtjes. Ky trajnim do të mbahet në ambientet e Prodhuesit.

4. 12 persona nga Albcontrol do të trajnohen për monitorimin dhe kontrollin e sistemit për të mundësuar personelin e Albcontrol për funksionimin e duhur të sistemit dhe kryerjen e nivelit 1 të mirëmbajtjes. Ky trajnim do të vendoset në ambientet e Aeroportit të Vlorës për stacionet e Vlorës dhe në ACC Tiranë për Sistemin Malor të Krujës . .

10.8 Sigurimi i Përgjithshëm i Cilësisë

Sigurimi i cilësisë (QA) do të planifikohet dhe kryhet për të siguruar që pajisja ose shërbimi që do të ofrohet plotëson kërkesat e specifikuara.

Sigurimi i cilësisë do të zbatohet në të gjitha aktivitetet e nevojshme për arritjen e këtij projekti.

Sigurimi i Cilësisë do të sigurojë objektivat e cilësisë; kërkesat dhe specifikimet janë përmbushur saktë dhe plotësisht.

10.8.1 Standardet e Cilësisë

Ofertuesi do të miratohet sipas ISO 9001/9002 ose me një standard ekuivalent. Për elementet e softuerit të kontratës, preferohet miratimi i ISO 9000-3.

Të gjithë komponentët e sistemit do të prodhohen nën një strukturë të certifikuar ISO 9000.

Këto procedura të miratuara të cilësisë do të zbatohen si për aspektet harduerike ashtu edhe për ato softuerike të kontratë

11. Shtojca A: Fusha e Punës

11.1 Sasia dhe koha e dorëzimit

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Koha
1	Stacioni në Gadishullin e Karaburunit	1 sistem	6 muaj
2	Stacioni në Aeroportin e Vlorës	1 Sistemi	4 muaj
3	Stacioni në malin e Krujës	1 Sistemi	6 muaj
4	Pjesë këmbimi	1 Set	8 muaj
5	Trajnimi	1 set	8 muaj

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Afatet e lëvrimit: 8 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022, 2023 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001: 2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- **ISO 27001:2017** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të sigurojë deklaratën e pershtatshmerisë për përdorim sipas rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit **EU) 2018/1139**, e transpozuar me VKM nr.1095 datë 24.12.2020 dhe Rregullores së Deleguar të Komisionit (EU) 2023/1768, **Ose** Udhëzimit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr.8 datë 03.06.2010, i rishikuar me Udhëzimin e Minsitrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr.5 datë 15.09.2015”.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose nga distributor i autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, çertifikatë, deklaratë etj).

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këte objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në D.T. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që A.K. të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në D.T.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë deklaratë për garancinë e mallit sipas specifikimeve teknike si dhe që mallrat janë brand origjinale (jo të asbluara, jo refurbished, të reja).

2.3.7 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre;

a) Minimumi 2 (dy) Inxhinierë elektronikë

Kërkesa e mësipërme duhet të vërtetohet me:

- Kontratë punë përkatëse
- Diplomat përkatëse
- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 25, të konfirmuara nga Administrata Tatimore që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.

b) Minimumi 2 Specialistë të certifikuar për "Punime në lartësi"

Kërkesa e mësipërme duhet të vërtetohet me:

